

VENDIM
Nr. 35, datë 11.12.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI NR. 4, DATË 11.3.2019, “PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR POZICIONET VAKANTE NË GJYKATËN KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË” (I NDRYSHUAR)

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229, dhe të pikës 6, të nenit 240, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (i ndryshuar), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

Në vendimin nr. 4, datë 11.3.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” (i ndryshuar) bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 4 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“4. Në ditën e mbledhjes së Këshillit zhvillohet procedura e shortit për caktimin e relatorit/relatorëve, sipas numrit të kandidatëve dhe vëllimit të punës së verifikimit. Si rregull, kandidatët ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet relatorëve të caktuar me short. Çdo relator përgatit projektaktet për kandidatët që i janë caktuar.”.

2. Pika 44 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“44. Këshilli vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Abstenimi nuk lejohet. Në rast barazie votash, vota e Kryetarit është vendimtare.”.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Sokol Sadushi

Anëtarë: Ilir Toska, Marjana Semini, Fuat Vjerdha, Etien Kapo, Enkela Vlora, Genti Xholi, Alma Muça, Nafije Hasko